



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex-officio nr.567/2019

në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në rastin e K. V.

Për: Z. Kujtim Munishi, ud. kryeprokuror, Prokuroria Themelore në Prishtinë
Z. Skender Reçica, ministër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Z. Rashit Qalaj, drejtor, Drejtoria e Përgjithshme, Policia e Kosovës

Prishtinë, më 6 dhjetor 2019

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së institucioneve publike lidhur me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën për jetë në rastin e K.V., të cilit, më 11 korrik 2019, i është marrë jeta nga një person tjetër.
2. Gjithashtu, ky raport vlerëson se sa kanë qenë efektive dhe të shpejta veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente shtetërore me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, në këtë rast në mbrojtjen e të drejtave të K.V., si dhe detyrimet e shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si me dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Baza ligjore

3. Avokati i Popullit, në mes të tjerash, sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës¹ (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit², Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 16/26 qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 3.1 *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve tjera shtetërore; (neni 135, paragrafi 3 i Kushtetutës);*
 - 3.2 *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
 - 3.3 *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
 - 3.4 *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Ligjit për Avokatin e Popullit);*
 - 3.5 *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
 - 3.6 *të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 i Ligjit për Avokatin e Popullit).”*
4. Avokati i Popullit e dërgon këtë raport tek institucionet kompetente si dhe e publikon në ueb-faqen e vet, në mënyrë që të evitohen shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe të respektohen ligjet në fuqi, siç kërkohet edhe nga parimi i sundimit të ligjit.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

Faktet

5. Më 17 korrik 2019, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka hapur hetimet sipas detyrës zyrtare “Ex officio”, pas shkrimit të portalit “Gazeta Express”, datë 15 korrik 2019, me titullin: “*Detaje të autopsisë nga vrasja e 11-vjeçarit-viktima ishte dhunuar seksualisht 3 herë*”. Sipas portalit, rasti për abuzim seksual ishte paraqitur në stacionin policor në Fushë Kosovë në janar të vitit 2019, mirëpo kundër të dyshuarit policia kishte ngritur vetëm kallëzim penal.
6. Më 18 korrik 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), përmes një deklaratë, ka apeluar tek institucionet shtetërore që t’i zbatonin detyrimet pozitive të shtetit për ta garantuar të drejtën për jetë si një e drejtë themelore e secilit.³ Gjithashtu IAP-ja, në disa raporte të publikuara më herët, ka adresuar tek institucionet përgjegjëse rekomandime që kanë të bëjnë me qasjen proaktive që shteti duhet ta ketë ndaj përmbushjes së detyrimeve pozitive në garantimin e së drejtës për jetë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.⁴
7. Më 18 korrik 2019, përfaqësuesit e IAP-së ishin takuar me përfaqësuesin e Policisë së Kosovës në Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejme: PK) për të marrë informata lidhur me çështjen si dhe e kishin siguruar dokumentacionin për çështjen (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i çështjes në PK) lidhur me raportimin e rastit në PK për abuzim seksual të viktimës K.V. (në tekstin e mëtejme: viktima) nga i dyshuari S. O. (në tekstin e mëtejme: i dyshuari) në janar të vitit 2019.
8. Sipas dokumentacionit të çështjes në PK, më 29 janar 2019, R. O., babai i të dyshuarit (në tekstin e mëtejme: babai i të dyshuarit) e kishte informuar PK-në se djali i tij kishte marrë fëmijë të lagjes, në këtë rast viktimën, me të cilin kishte kryer marrëdhënie seksuale.⁵ Këto informata babai i të dyshuarit i kishte marrë nga nëna e viktimës. Ai kishte pohuar me atë rast se djali i tij ishte edhe përdorues i substancave narkotike dhe kohën kur nuk i përdorë ato, bëhet agresiv me anëtarët e familjes.
9. Sipas dokumentacionit të çështjes në PK, më 30 janar 2019, PK-ja e kishte njoftuar Qendrën për Punë Sociale (në tekstin e mëtejme: QPS) në Fushë Kosovë dhe së bashku kishin shkuar në shtëpinë e nënës së viktimës të cilën nuk e kishin gjetur aty.⁶
10. Më 31 janar 2019, nga PK-ja ishte intervistuar nëna e viktimës si dëshmitare, e cila për rastin në fjalë e kishte njoftuar babanë e të dyshuarit.⁷ Pas intervistimit të babait të të dyshuarit dhe të nënës së viktimës, ishte njoftuar prokurorja e shtetit, kujdestare, e cila kishte udhëzuar që fillimisht rasti të mbetej proform dhe të hetohej në kuadër të PK-së dhe pasi të intervistohej edhe i dyshuari, të njoftohej Prokuroria Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: PThP).

³ <https://www.oik-rks.org/2019/07/18/avokati-i-popullit-fillon-hetimet-sipas-detyres-zyrtare-per-rastin-e-vdekjes-se-femijes-9-vjecar-nga-fushe-kosova/>

⁴ <https://www.oik-rks.org/2016/08/10/raport-ex-officio-ne-lidhje-me-te-drejtjen-per-jete-10-gusht-2016/>;
<https://www.oik-rks.org/2016/09/26/raport-me-rekomandime-i-avokatit-te-popullit-lidhur-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-perkitazi-me-trajtimin-e-detyrueshem-psikiatrik-2/>;
<https://www.oik-rks.org/2015/11/03/raport-me-rekomandime-892015-lidhur-me-te-drejtjen-ne-jete/>;
<https://www.oik-rks.org/2019/08/01/raport-me-rekomandime-ex-officion-rasti-nr-346-2019/>;
<https://www.oik-rks.org/2019/08/01/raport-me-rekomandime-ex-officion-rasti-nr-346-2019/>

⁵ Raporti i Policisë 53/19.

⁶ Shënim zyrtar i PK-së.

⁷ Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit M. B., 31 janar 2019.

11. Më 4 prill 2019, sipas dokumentacionit të çështjes në PK, i dyshuari për dhunim seksual ishte intervistuar nga PK-ja, i cili kishte pranuar se kishte kryer marrëdhënie seksuale me viktimën. Po ashtu, pas intervistimit të të dyshuarit, ishte kontaktuar prokurori i shtetit, kujdestar në PThP, i cili kishte urdhëruar që rasti të hapej për vepër penale: ***kryerja e marrëdhënieve seksuale me personin nën moshën 14 vjeç***, dhe që rasti të hetohet në procedurë të rregullt.
12. Pas analizimit të dokumentacionit të çështjes në PK, Avokati i Popullit ka vërejtur se kundër të dyshuarit ishin referuar në Prokurorinë e Shtetit një numër i madh i rasteve për dyshimin e kryerjes së veprave të caktuara penale.⁸
13. Më 11 prill 2019, ishte marrë në pyetje viktimja, i cili, në praninë e nënës së vet, kishte deklaruar se i dyshuari fillimisht i kishte dhënë substanca narkotike dhe më pastaj e kishte rrahur dhe së fund kishte kryer marrëdhënie seksuale.⁹ Pas intervistimit të viktimës, sipas dokumentacionit, PK-ja e kishte informuar PThP-në dhe e kishte marrë njoftimin se nuk ka nevojë për ekzaminim mjeko-ligjor.
14. Më 12 prill 2019, PK-ja, në bazë të nenit 81, paragrafët 1 dhe 2, të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë,¹⁰ kishte parashtruar kallëzim penal në PThP kundër të dyshuarit për kryerjen e veprës penale: ***“Keqpërdorim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet”***, sipas nenit 235, paragrafit 2, të Kodit nr. 04/l-082 Penal të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.¹¹
15. Më 18 korrik 2019, përfaqësuesit e IAP-së ishin takuar me përfaqësuesit e QPS-së në Fushë Kosovë, me të cilët kishin biseduar lidhur me çështjen dhe e kishin siguruar dokumentacionin e çështjes.
16. Më 25 korrik 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me përfaqësuesin e QPS-së, i cili ka pohuar se kishin kërkuar për të biseduar me fëmijën, por ai kishte refuzuar vazhdimisht. Gjithashtu ai ka pohuar se nuk kanë psikolog, andaj kishin kërkuar nga psikologu i kontraktuar që të bisedonte me fëmijën. Sipas pohimeve të QPS-së, nëna e fëmijës nuk ka qenë shumë bashkëpunuese, por vazhdimisht janë munduar t'i ofronin këshillime.
17. Sipas pohimeve të QPS-së dhe dokumentacionit të siguruar (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i çështjes në QPS), më 6 dhjetor 2018, nëna e viktimës, me katër fëmijët e vet, kishte shkuar në QPS për t'i marrë shërbimet e nevojshme sociale, përkatësisht këshillim për fëmijën e vet me aftësi të kufizuar M. V., ku u ishte sugjeruar që ta kompletonte dokumentacionin mjekësor si dhe të aplikonte në skemën e ndihmës sociale për fëmijën. E njëjta kishte aplikuar në këtë skemë sociale dhe më pas i ishte njohur e drejta për realizimin e saj në shumën prej 375 eurosh.
18. Sipas dokumentacionit të çështjes në QPS, nëna e viktimës, së bashku me katër fëmijët e vet, kishte dalë në rrugë për të kërkuar lëmshë.¹² Lidhur me këtë, në dhjetor të vitit 2018,

⁸ KPRK: neni 178 - Vrasje; neni 188 - Lëndimi i lehtë trupor; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 187 - Sulmi; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja; neni 325 - Vjedhja e rëndë; neni 325 - Vjedhja, dhe së fundmi neni 325 - Keqpërdorim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç.

⁹ Procesverbali i marrjes në pyetje i viktimës, 11.4.2019

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>.

¹² Forma 001, nr. dosjes 1140/29, i dt. 06.12.2018 dhe Forma 005 i K.V.

QPS-ja e kishte vizituar familjen e saj dhe i ishte tërhequr vërejtja për të mos dalë në rrugë për të kërkuar lëmshë, duke ia bërë me dije se ishte kundër interesit të fëmijëve. Ndërsa më 7 janar 2019, përfaqësuesi i QPS-së e kishte vizituar familjen e viktimës me qëllimin për ta verifikuar nëse nëna ishte duke iu përmbajtur këshillimeve. Gjithashtu, sipas dokumentacionit të çështjes, nëna ishte gjetur në vendin ku jeton, së bashku me katër fëmijët e vet dhe se nuk ishte vërejtur ndonjë gjë serioze. Familja ishte vizituar vazhdimisht dhe nënës i ishte tërhequr vërejtja për të mos dalë me fëmijë në rrugë për të kërkuar lëmshë.¹³

19. Më 31 janar 2019, QPS-ja ishte informuar nga PK-ja lidhur me rastin, përkatësisht për dyshimin se ndaj viktimës është kryer dhunë seksuale nga i dyshuari.
20. Nga dokumentacioni i çështjes në QPS del se më 1 shkurt 2019, në orën 12:10, nëna e viktimës e kishte paraqitur rastin në PK për dhunë në familje nga personi me të cilin ajo bashkëjetonte, i cili kohë pas kohe i shkaktonte probleme.
21. Më 7 shkurt 2019, nëna e viktimës, me fëmijët e vet, ishte vendosur në strehimoren përkatëse, ndërsa më 8 shkurt 2019, ishte bërë tërheqja e nënës me fëmijët nga strehimorja dhe ishte vendosur në shtëpinë e vet në Fushë Kosovë.
22. Më 13 shkurt 2019, QPS-ja e kishte vizituar familjen e viktimës, sepse ai nuk e kishte vijuar procesin mësimor.¹⁴ QPS-ja e kishte këshilluar viktimën që ta vijonte mësimin në shkollën fillore, mirëpo ai e kishte refuzuar këtë, duke pohuar se nuk dëshironte të shkonte në shkollë. Në dokumentacionin e çështjes nuk vërehet se QPS-ja të ketë bërë ndonjë veprim shtesë qoftë edhe me institucionet e tjera që fëmija ta vijonte procesin mësimor në shkollën fillore.
23. Më 12 mars 2019, sipas dokumentacionit të çështjes në QPS, familja ishte njoftuar për shërbimin psikologjik nga psikologu i kontraktuar nga QPS-ja për viktimën.
24. Më 13 mars 2019, psikologu e kishte vizituar familjen, përkatësisht fëmijën viktimë. Konstatimi i psikologes ishte se fëmija ishte i mbyllur, më vonë ishte rrëfyer dhe kishte pranuar se kishte qenë dy herë i keqtrajtuar nga personi i dyshuar. Takimi kishte zgjatur vetëm 25 minuta.
25. Më 11 korrik 2019, viktimja K.V. ishte gjetur i vdekur, poshtë shkallëve të një kompleksi banesor në lagjen "Xhemail Mustafa" në Fushë Kosovë. Sipas familjes, ai dyshohej se ishte dhunuar seksualisht dhe pastaj ishte vrarë nga një person derisa po kërkonte kanaçe nëpër rrugët e këtij qyteti.¹⁵
26. Më 7 gusht 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, kishte kërkuar nga PThP-ja që ta informonte për veprimet që ishin ndërmarrë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore, lidhur me rastin, për periudhën kohore 29 janar deri më 10 korrik 2019. Për kërkesën në fjalë, Avokati i Popullit nuk kishte marrë përgjigje.
27. Po ashtu, përmes shkresës (7 gusht 2019), Avokati i Popullit ka kërkuar informata nga PThP-ja në disa pyetje, në mënyrë që të kihen informatat e duhura dhe pasqyra e qartë

¹³ Vizita dhe tërheqja e vërejtjes nënës së viktimës nga përfaqësuesit e QPS-së: më 8 shkurt 2019; më 13 shkurt 2019; më 12 mars 2019; më 26 mars 2019; më 7 maj 2019; dhe më 4 qershor 2019.

¹⁴ Sipas informatave nga dokumentacioni i çështjes.

¹⁵ <https://www.gazetaexpress.com/detaje-te-autopsise-nga-vrasja-e-11-vjecarit-viktima-ishte-dhunuar-seksualisht-3-heree/>

lidhur me rastin e paraqitur në PK, më 29 janar 2019: “...A është intervistuar viktimë K.V. nëse po kur dhe a është bërë ndonjë ekzaminim mjekoligjor apo ndonjë referim tek institucionet tjera kompetente në ofrimin e shërbimeve përkatëse të viktimës K.V.? (...) A ka pasur urdhër për arrestim të dyshuarit S.O. dhe cilat janë masat ligjore që janë ndërmarr nga PThP ndaj të dyshuarit nga data 29 janar 2019 deri me 10 korrik 2019 lidhur me rastin. Cilat veprime janë ndërmarr nga PThP pas arrestimit apo ndalimit të të dyshuarit S.O., para datës 10 korrik 2019? (...)”.

28. Më 11 shtator 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës përsëritëse, ka kërkuar nga PThP-ja përgjigje në shkresën e datës 7 korrik 2019. Gjithashtu ka tërhequr vëmendjen në nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenet 18 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, që u bëjnë thirrje autoriteteve publike t’u përgjigjen kërkesave të IAP-së për sigurimin e informacioneve, dokumenteve dhe dosjeve brenda kohës së arsyeshme.
29. Më 18 shtator 2019, IAP-ja ka marrë përgjigje nga PThP-ja: “... lënda është pranuar në Prokurori me datë 15 prill 2019. Më 11.06.2019, është marrë aktvendim për fillim të hetimeve me qëllim të pandehuri S. O. është ftuar me ftesë në prokurorinë Themelore në Prishtinë, ftesa është pranuar nga i njëjti, mirëpo nuk është paraqitur në Prokurori. Ftesa e dytë të pandehurit i është dërguar me datë 21.05.2019 dhe i njëjti prapë e ka pranuar por nuk është paraqitur. Me datë 26.06.2019 është pezulluar hetimi. Në Prokurorinë Themelore në Prishtinë janë paraqitur gjithsej 26 kallëzime penale dhe ndaj tij janë ngritur 15 aktakuza.” Avokati i Popullit nuk ka marrë të dhëna të cilat do ta arsyetonin pezullimin e hetimit të rastit.
30. Deri në publikimin e këtij raporti, Avokati i Popullit nuk mori përgjigje në lidhje me pyetjet e parashtuara sipas paragrafit 25 të këtij raporti. Në këtë rast, PThP-ja nuk veproi në pajtim me nenin 24, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t’i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen në fjalë.
31. Më 23 shtator 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me përfaqësuesin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV), nga i cili është informuar se lidhur me rastin, Mbrojtësit e Viktimave (MV) nuk janë ftuar nga PK-ja.

Instrumentet relevante ligjore

32. Ekzistojnë një varg instrumentesh ligjore që e rregullojnë këtë çështje, por pa u kufizuar te:

32.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta),¹⁶ në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.” Paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.” Po ashtu, paragrafi 3 thotë: “Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”

32.2. Më tutje, Kushtetuta në nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] përcakton: “1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e

¹⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

- tyre.” Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”
- 32.3. Po ashtu, Kushtetuta në nenin 25 [E Drejta për Jetën], paragrafi 1, përcakton: “Secili individ gëzon të drejtën për jetën.” Më tutje, neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal] parasheh: “Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj (...).”
- 32.4. Kushtetuta në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] përcakton: “Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”
- 32.5. Kushtetuta në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] përcakton: “Te drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (...) (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (...) (...) (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijë. (...)”
- 32.6. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejme: KEMDNj), në neni 2, përcakton: “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj (...)”
- 32.7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejme: KDF), në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: “Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”
- 32.8. KDF-ja në nenin 6 përcakton: “Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.(...)”
- 32.9. KDF-ja në nenin 19 përcakton: “1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, **përfshirë abuzimin seksual**, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. (...)”
- 32.10. Gjithashtu, KDF-ja në nenin 32 përcakton: “1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin e tij, ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror (...)”
- 32.11. KDF-ja në nenin 34 përcakton: “Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual.(...)”
- 32.12. Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: viti ii / Nr.

12 / 01 maj 2007 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 02/L-17), i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 5 / 05 prill 2012, Prishtinë¹⁷(në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 04/L-081), pos tjerash, rregullon: “...ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut...”

- 32.13. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 16 / 26 qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 05/L-021)¹⁸, në nenin 1, paragrafi 1, përcakton: “1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, **gjendjes sociale** ose personale, **moshës**, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”
- 32.14. Ligji nr. 05/L-021, në nenin 2, përcakton: “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: (...) 1.5. mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore; 1.6. përparësit sociale; 1.7. lehtësitë sociale, përfshirë, por pa u kufizuar në ndihmën humanitare; (...)”
- 32.15. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 04 / 19 mars 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Policinë)¹⁹, rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.
- 32.16. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: KPP)²⁰, pos tjerash, përcakton rregullat e procedurës penale, të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, të prokurorisë së shtetit, si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.

¹⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2808>

¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

¹⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

²⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

32.17. Kodi nr. 04/l-082 Penal i Republikës së Kosovës, neni 235 (Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë 16 vjet), përcakton: “(...) 2. *Kushdo që kryen veprat penale në vijim ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet siç përcaktohet në vijim: 2.1. kryesi i cili kryen veprën penale të dhunimit nga neni 230 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim. 2.2. kryesi i cili kryen veprën penale të përdorimit të shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim. 2.3. kryesi i cili kryen veprën penale të sulmit seksual nga neni 232 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në (20) njëzet vjet. 2.4. kryesi i cili kryen veprën penale të degradimit të integritetit seksual nga neni 233 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. (...) 5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se njëzet (20) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjithashtu paragrafi 4 i këtij neni parasheh edhe rastet kur kryerësi dënohet me jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim²¹.*

32.18. Ligji nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë,²² rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.

Analiza

33. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës, kjo përfshin edhe të drejtat e fëmijëve. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut,²³ prandaj ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet respektuar nga të gjithë, përfshirë edhe rastet kur kemi të bëjmë me një fëmijë i cili cilësohet si viktimë e ndjeshme, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.²⁴

34. E drejta për jetë, si një nga të drejtat e garantuara me Kushtetutë, kërkon ndërmarrjen e veprimeve përkatëse nga institucionet shtetërore për mbrojtjen e saj. Kjo e drejtë gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe është e drejtë absolute, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, nuk lejohet shmangia nga kjo e

²¹ Kodi nr. 04/l-082 Penal i Republikës së Kosovës, neni 235, paragrafi 4: “4.1. *veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor; 4.2. kryesi përdor forcë; 4.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktimës tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale; 4.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm; 4.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera; 4.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person; 4.7. kryesi e di se personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës apo shtatzënisë; (...).”*

²² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

²³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21.

²⁴ Viktimë e ndjeshme është viktimë e veprës penale e cila është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryerësit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur (shih neni 113, paragrafi 39, i Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës).

drejtë.²⁵ Po ashtu, Kushtetuta parasheh se secili person e ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik të tij/saj, ku edhe kjo e drejtë ngërthen detyrime pozitive nga ana e shtetit për t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur pacenueshmërinë e saj. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin KI. 41-12,²⁶ ka gjetur se kishte shkelje të së drejtës për jetë në rastet kur organet kompetente të shtetit nuk u ofronin mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve të ekspozuar rrezikut dhe kur për këtë e kërkonin rrethanat e rastit. Gjykata kishte theksuar se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe kishte sqaruar se ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre që i janë ekspozuar rrezikut. Kjo vlen edhe për rastin në fjalë të viktimës fëmijë.

35. Më tutje, Kushtetuta përcakton së fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, nga keqtrajtimi dhe nga eksploatimi.²⁷ Gjithashtu, të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.²⁸ Rrjedhimisht kanë ekzistuar obligimet shtetërore për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta siguruar mbrojtjen e jetës së fëmijës, në këtë rast viktimës K. V., dhe mbrojtjen nga abuzimet dhe keqpërdorimet, si dhe mbrojtje të tjera në të gjitha fushat e jetës që kanë qenë në interes të mirëqenies së tij.
36. KDF-ja, si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijës, ka paraparë se e drejta e fëmijës për jetë dhe obligimi i shteteve për t'i marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës përbën jo vetëm një nga të drejtat themelore të Konventës²⁹, por edhe një ndër katër parimet kryesore në interpretimin dhe zbatimin e saj.³⁰ Sipas Komitetit të KDF-së, shtetet duhet të interpretojnë “zhvillimin e fëmijës” në kuptimin e tij më të gjerë si një koncept gjithëpërfshirës që nënkupton zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe shoqëror të fëmijës.³¹ Po ashtu, të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, nga autoritetet administrative apo nga organet legjislative, duhet që interesin më të lartë të fëmijës ta kenë konsideratë parësore.³² Konventa parasheh obligimet e shtetit në marrjen e të gjitha masave të përshtatshme legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës duke përfshirë abuzimin seksual. Këto masa përfshijnë, ndër tjerash, edhe parandalimin, identifikimin, raportimin, referimin, **hetimin**, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijës qoftë nëpërmes proceseve gjyqësore.³³ Mënyra e formulimit të këtij obligimi nuk le hapësirë për

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 56.

²⁶ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/12, parashtrues Gezim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komonale në Prishtinë dhe kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i njohur në publik si rasti Diana Kastrati.

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50, para.1 dhe 3.

²⁸ Po aty, para. 4.

²⁹ KDF, neni 6.

³⁰ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr.5 të Konventës të miratuar nga Komiteti i KDF-së, në: <https://www.refworld.org/docid/4538834f11.html>.

³¹ Po aty, para. 12.

³² KDF, neni 3(1).

³³ Po aty, neni 19.

diskrecion të lirë të shteteve dhe shtetet kanë një detyrim të rreptë të ndërmarrin “gjithçka që është masë e përshtatshme” për ta zbatuar plotësisht këtë të drejtë për të gjithë fëmijët.³⁴ Për më tepër, personat përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve duhet të jenë profesionistë të trajnuar, të cilët japin një vlerësim multi-disiplinor për nevojat afatgjata dhe afatshkurtra të fëmijës, kujdestarëve dhe familjes, i cili përfshin dhe i jep peshë të duhur pikëpamjeve të fëmijëve si dhe të familjes, referon fëmijën dhe familjen tek një sërë shërbimesh për t’i përmbushur ato nevoja; përcjell dhe vlerëson përshtatshmërinë e intervenimit.³⁵ Hetimi po ashtu duhet të ndërmerrret nga profesionistë të kualifikuar me bazë në të drejtat e fëmijëve dhe me qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve. Duhet pasur kujdes të veçantë që fëmija të mos viktimizohet më tutje.³⁶ Trajtimi i këtyre rasteve nënkupton ofrimin e shërbimeve mjekësore, të shëndetit mendor, sociale dhe ligjore, si dhe të shërbimeve përcjellëse afatgjata. Njëkohësisht, kushtet e jetës së këtyre fëmijëve duhet të ekzaminohen në mënyrë që të promovojnë kujdesin dhe mbështetjen e tyre.³⁷

37. Përcjellja e procesit në mënyrë që të jetë efektiv kërkon që veprimet, pasi të vendoset përmes një procesi pjesëmarrës, ku dëgjohet edhe mendimi i fëmijës dhe i familjes, nuk duhet t’i nënshtrohen vonesës së padrejtë.³⁸ Përfshirja gjyqësore në çdo kohë dhe në të gjitha rastet duhet ta respektojë parimin e procesit të rregullt gjyqësor. Në veçanti, mbrojtja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i fëmijës, që merr parasysh interesin më të mirë të tij, duhet ta formojë qëllimin kryesor të marrjes së vendimeve.³⁹ Në të gjitha procedurat ku janë të përfshira fëmijët viktimë të dhunës duhet të aplikohet parimi i kryerjes sa më të shpejtë të veprimeve, duke respektuar sundimin e ligjit.⁴⁰ Për më tepër, veprimet e ndërmarra duhet t’i kenë parasysh faktorët e ndryshëm që i bëjnë fëmijët më të ndjeshëm ndaj dhunës, siç janë varfëria dhe diskriminimi, si dhe përkatësia në kategori të cenueshme, siç janë fëmijët në situatë rruge dhe të qenit pjesë e minoriteteve etnike.⁴¹
38. Në rastin në fjalë nuk ka indikatorë se autoritetet shtetërore kanë marrë parasysh ndonjë nga faktorët e lartcekur. Procedurat e kontaktimit të viktimës dhe ofrimit të shërbimeve mjekësore dhe psikologjike kanë qenë të stërzgjatura dhe të mangëta. Përkundër dhunës së rëndë seksuale që ka përjetuar viktimë e ndjeshme fëmijë, ai ka marrë vetëm një trajtim 25 minutash nga psikologu. Dhuna ndaj fëmijëve është jashtëzakonisht komplekse dhe me pasoja të rënda psiko-sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Hulumtimet tregojnë se nëse fëmija ka përjetuar cilëndo formë të abuzimit dhe nëse nuk e ka marrë ndihmën e nevojshme, do të ketë pasoja negative më vonë si i rritur dhe do të jetë e vështirë të tejkalohej pa trajtim adekuat.⁴² Nuk ka të dhëna që pikëpamjet e tij dhe të familjes së tij të jenë marrë parasysh në asnjë nga hapat e procedurës. Nuk ka asnjë lloj vlerësimi për masat afatshkurtra dhe afatgjata të integritetit të tij në shoqëri. Rasti nuk është trajtuar me prioritet nga prokuroria dhe as nga policia. Siç do të

³⁴ Komiteti i KDF-së, Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 (2011) E drejta e fëmijës për liri nga të gjitha format e dhunës, par. 37, në: <https://www.refworld.org/docid/4e6da4922.html>.

³⁵ Po aty, par. 50.

³⁶ Po aty, par. 51.

³⁷ Po aty, par. 52.

³⁸ Po aty, par. 53.

³⁹ Po aty, par. 54.

⁴⁰ Po aty, par. 54(d).

⁴¹ Po aty, par. 72.

⁴² Opinioni i Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhen ndërmarrë institucionet përgjegjëse (më 15 nëntor 2016).

elaborohet edhe më poshtë, këto institucione nuk kanë ndërmarrë asnjë masë të cilën e parasheh ligji, për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale e as sigurimin e viktimës, pavarësisht faktit se i dyshuari, gjatë intervistimit nga policia, e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer në prill.

39. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Evropiane), neni 2 i KEMDNj-së është i rëndësishëm për këtë analizë. Gjykata Evropiane ka ritheksuar se neni 2 duhet të konsiderohet si një nga dispozitat më themelore të Konventës dhe se ai përbën një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike që përbëjnë Këshillin e Evropës (shih Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 korrik 1989, § 88, Seria A nr. 161). Kjo e drejtë kërkon që shteti jo vetëm që të përmbahet nga marrja “e qëllimshme” e jetës, por edhe t’i ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që janë nën juridiksionin e tij.
40. Ky detyrim pozitiv përfshin, së pari, një detyrë parësore të shtetit për të siguruar të drejtën e jetës, duke vendosur një kornizë legjislative dhe administrative të dizajnuar për të siguruar një pengesë efektive kundër kërcënimeve për të drejtën e jetës (shih, Öneriyıldız kundër Turqisë, [GC] nr. 48939/99, 89 §, KEDNj 2004-XII). Së dyti, në rrethana të caktuara ekziston një detyrim pozitiv nga autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për ta mbrojtur një individ, jeta e të cilit rrezikohet nga veprimet kriminale të një individi tjetër (shih Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, § 116, 1998-VIII). Fëmijët dhe individët e tjerë të cenueshëm në veçanti e kanë të drejtën e mbrojtjes së shtetit (Talpiş kundër Italisë, nr. 41237/14, § 99, 2 mars 2017).
41. Detyrimet pozitive lindin kur vërtetohet se autoritetet kishin njohuri, ose do to duhej të kishin njohuri, për ekzistimin e rrezikut real dhe të menjëhershëm për jetën e një personi, të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk i kanë ndërmarrë masat e duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin të ndërmerreshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë (*Osman kundër Britanisë së Madhe*).
42. Gjatë interpretimit të nenit 2 të Konventës në rastin *Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë, të datës 15 janar 2009*, lidhur me detyrimet pozitive, Gjykata ka konstatuar që autoritetet ishin në dëgjim për seriozitetin e kërcënimeve, por dështuan në ndërmarrjen e detyrimeve pozitive.
43. Në rastin konkret, policia dhe prokuroria kanë qenë të informuara se i dyshuari ka ushtruar dhunë seksuale kundër viktimës. Për këtë fakt ata kanë qenë të informuar nga katër burime: babai i të dyshuarit, nëna e viktimës, viktima dhe vetë i dyshuari. Babai i të dyshuarit e ka informuar policinë se djali i tij bëhet agresiv kur nuk përdor substanca narkotike. Viktima ka rrëfyer se vepra penale kryerje e marrëdhënieve seksuale është kryer në rrethana rënduese, pasi që i dyshuari po ashtu ka ushtruar dhunë fizike ndaj viktimës, duke e rrahur atë dhe i ka dhënë substanca narkotike një fëmije 11 vjeçar që po ashtu është vepër tjetër penale në vete. Për më tepër, kundër të dyshuarit janë paraqitur 26 kallëzime penale dhe janë ngritur 15 aktakuza në prokurori. Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, atëherë është e qartë se ka ekzistuar rreziku real dhe i menjëhershëm për jetën e viktimës dhe autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë qenë në dëgjim, nuk kanë ndërmarrë një mori masash të cilat kanë qenë në dispozicion të parapara me Kodin e Procedurës Penale

dhe për të cilat do të ishte e arsyeshme të merreshin dhe, si rrjedhojë, kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve përkatëse. Sidomos, siç e ka theksuar Gjykata Evropiane, fëmijët dhe individët nga grupet e cenueshme në veçanti e kanë të drejtën e mbrojtjes nga shteti dhe, në këtë rast, viktima ka pasur nevojë për mbrojtje të shumëfishtë, duke qenë se ai ka qenë edhe fëmijë edhe pjesë e një komuniteti të cenueshëm e të marginalizuar në Kosovë.

44. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, viktima në rastin konkret cilësohet si viktimë e ndjeshme, ndërsa Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, neni 1, paragrafi 3, përcakton: “*Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të (...) rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi (...) ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtar (...)*”, pra këtu përket edhe rasti në fjalë. Aq më tepër kur dihet se QPS-ja ishte në dijeni se viktima ishte edhe “fëmijë në situatë rruge”,⁴³ si element potencial dhe bazik për të vlerësuar se kundër viktimitë ekzistonte rreziku serioz, i menjëhershëm për shëndetin, për sigurinë dhe për mirëqenien e tij, institucionet përkatëse është dashur të vepronin me urgjencë në mbrojtjen e fëmijës dhe natyrisht, pas vlerësimit të situatës në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi, t’i ndërmerren masat e nevojshme për ta parandaluar, për ta trajtuar dhe për ta adresuar në mënyrë adekuate çështjen e viktimitë si fëmijë në situatë rruge dhe si fëmijë i abuzuar seksualisht. Për më shumë, viktima i ka takuar komunitetit ashkali dhe ka jetuar në një familje ku është raportuar për dhunë në familje dhe në gjendje të rëndë ekonomike. Të gjitha këto rrethana e kanë rënduar edhe më shumë gjendjen e tij psikologjike dhe shoqërore.
45. Sipas deklarimeve të përfaqësuesit të QPS-së, kishin kërkuar që të bisedohet me fëmijën, por fëmija vazhdimisht kishte refuzuar. QPS-ja është dashur të jenë të informuar se një gjë e tillë është e pritshme nga një fëmijë i cili ka përjetuar dhunë. Personat e trajnuar për qasje në të drejtat e fëmijëve dhe për qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve do ta adresonin zgjidhjen e këtij problemi në forma të tjera dhe do të ishin më të vetëdijshëm se si t’i qaseshin një fëmije. Përfaqësuesi ka deklaruar se QPS-ja nuk kishin psikolog, andaj kishin kërkuar nga psikologu i kontraktuar që të bisedonte me fëmijën. Avokati i Popullit

⁴³ Për qëllimet e këtij raporti termi “**fëmijë në situatë rruge**” përdoret në pajtim me rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të KDF-së dhe përfshin: “(a) fëmijët që varen nga rruga për të jetuar ose punuar vetëm, me bashkëmohatarët ose me familjet e tyre; (b) një popullatë më të gjerë fëmijësh që kanë zhvilluar lidhje të ngushta me vendet publike dhe për të cilët rruga luan një rol vital në identitetin dhe jetën e tyre të përditshme. Kjo popullatë e gjerë përfshin fëmijët që kohë pas kohe (periodikisht) jetojnë ose punojnë në rrugë dhe fëmijët që nuk jetojnë ose punojnë në rrugë, por që rregullisht shoqërojnë bashkëmohatarët, vëllezërit e motrat apo familjet e tyre në rrugë. Në rastin e fëmijëve të rrugës, “të qenit i pranishëm në vende publike” do të thotë të kalosh shumë kohë në rrugë ose në tregjet e hapura, parqet publike, hapësira publike të komunitetit, sheshe, stacione të autobusëve dhe trenave. Ky term nuk përfshin institucionet publike siç janë shkollat, spitalet apo institucionet e tjera të krahaseshme.” (*Kombet e Bashkuara, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i përgjithshëm nr.21 për fëmijët në situatë rruge, III (4), 2017*). Ndërsa termi “**puna e fëmijëve**” përfshin: “të gjitha aktivitetet që i privojnë fëmijët nga fëmijëria, potencialet dhe dinjiteti i tyre dhe u bëjnë dëm shkollimit, shëndetit, zhvillimit fizik dhe mendor.” Ajo u referohet punëve: të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe zhvillimin fizik, social ose mental të fëmijëve; që pengojnë arsimimin e tyre duke i privuar ata nga çdo shkollim; duke i detyruar ata të heqin dorë nga shkolla para kohe; duke kërkuar nga ata që të përpiqen të kombinojnë ndjekjen e shkollimit me punë të vështira dhe orare të gjata.” (*Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), Korventa 138 mbi moshën minimale, Gjenevë, 1973*).

vëren se nga momenti kur është vënë në dijeni QPS-ja se viktimë mund të jetë abuzuar seksualisht, kanë kaluar rreth 43 ditë e që viktimë nuk ka marrë fare shërbime psikologjike. Në bazë të dokumentacionit të çështjes,⁴⁴ del se vetëm një herë viktimë ka pasur seancë psikologjike në kohëzgjatje prej 25 minutash dhe se përmbledhja e çështjes në dosje është bërë në mënyrë sipërfaqësore pa i përmbajtur udhëzimet për veprimet që do të duhej të ndërmerreshin më tutje në drejtim të ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes përkatëse për fëmijën. Rrjedhimisht, QPS-ja nuk ka qenë efektive në ofrimin e shërbimeve profesionale psikologjike për viktimën në pajtim me standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijët viktimë të krimeve seksuale.

46. Tutje, Ligji nr. 04/L-081 e përcakton organin e kujdestarisë si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të QPS-ve. Ky organ, në rastin konkret, ka dështuar në ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me detyrimet ligjore, në vlerësimin gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës dhe në kërkimin e masave mbrojtëse nga gjykata,⁴⁵ meqë ka ekzistuar dyshimi i bazuar se fëmija mund të ketë qenë viktimë e abuzimit seksual, përveç tjerash. Nga informatat dhe dokumentacioni të siguruara lidhur me rastin rezultoi se organi i kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen.
47. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, përkatësisht neni 10, përcakton se PK-ja, pos tjerash, ka për detyrë: ***“të mbrojtë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat, parandaloj dhe t’i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre si dhe të kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.”***⁴⁶ Ndërsa sipas nenit 16, zyrtari policor ka autorizim ta identifikojë personin tjetër atëherë kur: ***“1.1. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë vepra penale; 1.2. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi paraqet rrezik për personat ose pronën, ose është duke shkaktuar shqetësim; (...).”*** Në bazë të analizimit të informatave të siguruara dhe dokumentacionit të çështjes, Avokati i Popullit vëren se PK-ja, edhe pse ka qenë në dijeni se ka të bëjë me një person të dyshuar për kryerjen e shumë veprave të tjera penale (recidivist), dhe në rastin konkret për abuzim seksual të një të mituri, nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura në pajtim me këtë nen. Pra PK-ja ka dështuar në ushtrimin efektiv të mandatit të saj ligjor në ndalimin dhe arrestimin e tij.
48. Sipas nenit 20 të Ligjit për Policinë, zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme ta mbrojtë personin nga rreziku dhe nga dëmi, veçanërisht kur personi s’ka mundësi për t’u mbrojtur, apo ta identifikojë personin ose t’ia kufizojë lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jobashkëpunues ndaj masave më të lehta. Po ashtu, paragrafët 2 dhe 3 të nenit 20 e kanë paraparë edhe situatën dhe kohën e ndalimit të përkohshëm: ***“2. Ndalimi i përkohshëm policor zgjatë aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të policisë, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë, përjashtimisht në rastet kur personi është ende në gjendje të pamundësisë për t’u mbrojtur, por jo edhe më gjatë se gjashtë (6) orë të tjera. 3. Ndalimi i përkohshëm policor në pajtim me nën-paragrafin 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni mund***

⁴⁴ Forma 005, e datës 13 mars 2019, lidhur me rastin.

⁴⁵ Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 9.

⁴⁶ Në këtë rast i referohet edhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht pjesës së kapitullit IX, që ka të bëjë me veprimet fillestare të policisë.

të zgjasë deri njëzetekatër (24) orë, brenda këtij afati policia obligohet ta informojë prokurorin publik kompetent në përputhje me Kodin e Procedurës Penale (...).” Sipas të dhënave të dokumentacionit të çështjes, të siguruara në PK-ja, më 29 janar 2019,⁴⁷ PK-ja vihet në dijeni nga babai i të dyshuarit se djali i tij ka marrë fëmijë të lagjes, në këtë rast viktimën, me të cilin ka kryer marrëdhënie seksuale. Avokati i Popullit, pas analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të çështjes, vëren se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikimin, ndalimin apo arrestimin e personit të dyshuar, në pajtim me këtë dispozitë, pavarësisht faktit se e ka ditur emrin dhe mbiemrin e të dyshuarit, të kaluarën e tij jo të mirë me ligjin dhe rrethana të tjera që kërkojnë urgjencë veprimi (shih pikën 12 dhe 29 të këtij raporti). Pra, PK-ja ka dështuar të ndërmarrë veprime efektive në pajtim me këto dispozita.

49. KPP-ja, në nenin 70 (Veprimet hetimore të policisë) përcakton: “1. Pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer. 2. Policia heton veprat penale dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale. 3. Për të kryer detyrat nga ky nen, policia është e autorizuar që: 3.1. të mbledhë informata nga personat; 3.2. të kryejë kontroll të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre; 3.3. të kufizojë lëvizjen në zona të caktuara për kohën kur ky veprim është urgjentisht i nevojshëm; 3.4. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të vërtetuar identitetin e personave dhe të sendeve; 3.5. të organizojë kontrollimin për të zbuluar vendndodhjen e individit ose të sendit që kërkohet duke dërguar letërreshtimin; 3.6. të kontrollojë nën praninë e personit përgjegjës objektet e caktuara dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e caktuara që u përkasin atyre; 3.7. të konfiskojë kontrabandën apo sendet të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale, përveç nëse për një gjë të tillë nevojitet urdhri nga neni 105 të këtij Kodi; 3.8. të sigurojë ekzaminimin fizik të të dëmtuarit, në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi; 3.9. të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjeko-ligjor të atyre provave nga laboratorit i mjekësisë ligjore në pajtim me nenin 71 të këtij Kodi; 3.10. të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm në pajtim me nenin 73 të këtij Kodi; 27 3.11. të ndërmerr hapat e nevojshëm për të parandaluar një rrezik të menjëhershëm për publikun; 3.12. të ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të gjetur kryerësin dhe për të parandaluar kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja; dhe 3.13. të ndërmerr hapa dhe veprime tjera të nevojshme siç përcaktohet me ligj. 3. Për veprimet të cilat i ndërmarrin dhe për faktet dhe rrethanat e konstatuara nga hetimet e tyre, policia përpilon procesverbal, fotografi ose shënime zyrtar. 4. Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën. Penale.”
50. Një ndër masat e parapara me KPP, që ka mundur të ushtrohet nga policia, ka qenë edhe arrestimi i të dyshuarit. KPP-ja, në nenin 164, parasheh se arrestimi mund të bëhet me

⁴⁷ Raporti Policist 53/19.

autorizimin e prokurorit të shtetit kur plotësohen kushtet: ka dyshim të bazuar se ai ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose mund ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryejë. Për arsyet e cekura gjatë kësaj analize, IAP vlerëson se në rastin e caktuar janë përmbushur të dy kushtet për ta ushtruar këtë masë. Në këtë drejtim, duke u bazuar në pranimin e fajësisë, nenin 165 të KPP-së, ka ekzistuar mundësia që të dyshuarit t'i caktohej edhe masa e paraburgimit.

51. Avokati i Popullit gjithashtu vëren se, pas intervistimit të babait të të dyshuarit dhe të nënës së viktimës, PK-ja, më 31 janar 2019, e kishte informuar PThP-në, e cila kishte udhëzuar që rasti fillimisht të mbetej proform dhe të **hetohej në kuadër të stacionit policor**. Po ashtu ajo e kishte autorizuar PK-në që pas intervistimit të të dyshuarit prokuroria të kontaktohej përsëri. Avokati i Popullit vëren se i dyshuari ishte intervistuar tek pas gjashtëdhjetë e pesë (65) ditësh, nga koha kur ishte njoftuar PThP-ja. Rrjedhimisht, dokumentacioni i çështjes nuk përbën të dhëna me të cilat do të pasqyrohej dhe do të dëshmohej ndonjë veprim procedural-ligjor se si i dyshuari ishte ndaluar apo ishte arrestuar, si dhe për veprimet e tjera ligjore të cilat PK-ja ishte dashur t'i ndërmerre pas ndalimit apo pas arrestimit të tij. Ajo që vërehet në të dhënat e dokumentacionit është se intervistimi i të dyshuarit ishte bërë më 4 prill 2019. Në këtë intervistë i dyshuari kishte pranuar se ka kryer marrëdhënie seksuale me viktimën. Pra PK-ja ka dështuar që të jetë efektive në përmbushjen e mandatit ligjor sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 70 të KPP-së⁴⁸.
52. Avokati i Popullit vëren se viktimja ishte intervistuar shtatëdhjetë e dy (72) ditë pasi që PK-ja ishte njoftuar se fëmija mund të jetë viktimë e abuzimit seksual, shtu këtu faktin edhe vonesën e njoftimit për atë se si viktimë e mundshme konsiderohet edhe palë e dëmtuar (neni 62, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., i KPP-së). Po ashtu, sipas nenit 77, paragrafi 1, të KPP-së: *“Me rastin e mbledhjes së të dhënave nga i dëmtuari, policia informon të dëmtuarin për të drejtat e tij nga neni 62 i këtij Kodi dhe me kërkesën e të dëmtuarit apo kur i dëmtuari i përket njëres prej kategorive nga neni 62, paragrafi 1. i këtij Kodi, njofton Njësinë për Mbrojtje të Viktimave.”* Në rastin konkret ka rezultuar se Mbrojtësit e Viktimave nuk ishin ftuar për të qenë pjesë e procesit të ndihmës dhe mbështetjes së viktimës, me ç’ rast do ta ndihmonin dhe do ta lehtësonin procesin e adresimit përkatës të çështjes. Pra PK-ja nuk kishte vepruar në pajtim me këto dispozita ligjore.
53. Neni 70 i KPP-së i përcakton *“Veprimet hetimore të policisë”* para fillimit të procedurës penale, gjë që janë parakushte të domosdoshme për të filluar procedurën penale, në mënyrë që procesi penal të jetë efektiv. Në këtë rast, po ashtu nga hetimet e kryera, Avokati i Popullit vëren se PK-ja nuk i ka ndërmarrë veprimet përkatëse për përcaktimin

⁴⁸ Neni 70 i KPP-së, paragrafët 1 dhe 2: *“1. Pas pranimin të informatës për një veprë penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer. 2. Policia heton veprat penale dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.”*

e vendndodhjes së kryerësit, pavarësisht faktit se i ka pasur informatat e nevojshme dhe dyshimin se është kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. Po ashtu rezultoi se PK-ja nuk i ka ndërmarrë as veprimet e nevojshme për të siguruar ekzaminimin fizik të të dëmtuarit, sipas paragrafit 3 të nenit 70, në pajtim me nenin 144. Tek pas kalimit të gjashtëdhjetë e pesë (65) ditëve nga koha kur është vënë në dijeni për rastin e dyshuar për dhunim seksual, PK-ja ka kërkuar nga PThP-ja kryerjen e ekzaminimit mjekoligjor, e cila ka konsideruar se nuk është e nevojshme kryerja e tij. Avokati i Popullit verën se PK-ja ka dështuar ta zbatojë paragrafin 2 dhe paragrafin 3, nënparagrafin 3.8, të nenit 70 të KPP-së.

54. Edhe pse rasti ishte paraqitur më 29 janar 2019, PK-ja tek më 12 prill 2019 kishte parashtruar kallëzim penal në PThP kundër të dyshuarit për kryerjen e veprës penale **“Keqpërdorim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet”**. Më 7 korrik 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar informata nga PThP-ja se a ka pasur urdhër për arrestim të të dyshuarit dhe cilat masa ligjore janë ndërmarrë nga PThP-ja për të dyshuarin, nga 29 janar 2019 e deri më 1 korrik 2019, përveç tjerash, për veprimet e ndërmarra lidhur me rastin, nga data 29 janar 2019 e deri më 10 korrik 2019. Më 18 shtator 2019, PThP-ja e ka informuar IAP-në se lënda ishte pranuar në PThP më 15 prill 2019, ndërsa më 11 qershor 2019 është nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, meqë i pandehuri S. O. është ftuar me ftesë në PThP-së, të cilën ai e ka pranuar, mirëpo nuk është paraqitur në Prokurori. Ftesa e dytë të pandehurit i është dërguar më 21.5.2019, të cilën ai sërish e ka pranuar, por nuk është paraqitur në Prokurori. Sipas PThP-së, më 26 qershor 2019, është pezulluar hetimi. KPP-ja, përkatësisht neni 157, përcakton rastet kur prokurori pezullon hetimet.⁴⁹ Rrjedhimisht organet e hetuesisë kanë dështuar të jenë efektive në arrestimin dhe në ndalimin e të dyshuarit, vlerësimin e rastit, si dhe shqiptimin e masave ligjore për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.
55. Sipas dispozitave të KPP-së, i. pandehuri duhet t'i përgjigjet ftesës së Prokurorisë⁵⁰, mirëpo, meqë i dyshuari nuk iu ka përgjigjur ftesës së Prokurorisë, pos tjerash, kjo e fundit ka dështuar në ndërmarrjen e veprimeve ligjore shtesë në sigurimin e pranisë së të dyshuarit në procedurë penale, si subjekt procedural, të cilin e ngarkon dyshimi se ka kryer veprë penale, për të cilën është iniciuar procedura penale (*neni 174, nga paragrafi 2 deri te paragrafi 5, i KPP-së aplikohet përshtatshëmrisht edhe për Prokurorinë*). Prokurori i shtetit, për mospërgjigje nga i dyshuari në ftesën dërguar atij, është dashur të kërkonte urdhër-arrest që i dyshuari të sillej me forcë në procedurë penale. I dyshuari ka qëndruar i lirë prej 21 majit 2019, kur të dyshuarit i është dërguar ftesa e dytë, e deri më

⁴⁹ Shih neni 157 i KPP: *“1. Prokurori i shtetit mund të pezullojë hetimin me aktvendim nëse i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë, nëse është arratisur ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit. 2. Para se të pezullohet hetimi, mblidhen të gjitha provat e mundshme lidhur me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit. 3. Prokurori i shtetit rifillon hetimin pas eliminimit të pengesave të cilat e kanë shkaktuar pezullimin. 4. Prokurori i shtetit bën një shënim në procesverbalin e hetimit lidhur me kohën dhe arsyet e pezullimit të hetimit dhe kohën e rifillimit të hetimit. Prokurori i shtetit pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pezullimin. 5. Koha derisa hetimi është pezulluar nuk llogaritet në kohën për zbatimin e hetimit, e as në kohën për parashkrimin e veprës penale.”*

⁵⁰ KPP *“2. Pas thirrjes, i pandehuri detyrohet të paraqitet para prokurorit të shtetit. Neni 174, paragrafi 2, deri në 5, të këtij Kodi zbatohen përshtatshëmrisht. I pandehuri mund të paraqesë ankesë te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi ligjshmërinë e detyrimit të tij për t'u paraqitur para prokurorit të shtetit.”*

11 korrik 2019, kur i dyshuari dyshohet se ia ka marrë jetën fëmijës viktimë. Në këtë rast Avokati i Popullit vlerëson se PThP-ja do duhej të ishte me efikase dhe e shpejtë në sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale dhe se mosefikasiteti në ndërmarrjen e veprimeve adekuate ligjore ka sjellë deri te marrja e jetës së viktimës fëmijë.

Konstatimet

56. Avokati i Popullit, pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që i ka, nxjerr konkluzionin se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*, përkatësisht shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e së drejtës për jetë, si dhe të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje nga dhuna dhe keqtrajtimi, pasi që autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës së viktimës, të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
57. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet përgjegjëse ishin në dijeni për rrezikun të cilit fëmija viktimë i ishte ekspozuar si fëmijë në situatë rruge dhe si fëmijë i abuzuar seksualisht, andaj edhe kanë dështuar në ndërmarrjen e masave në lidhje me detyrimet pozitive, respektivisht mbrojtjen e jetës së viktimës.
58. Avokati i Popullit konsideron se QPS-ja do të duhej të kishte bërë më shumë për ta parandaluar, për ta trajtuar dhe për ta adresuar në mënyrë adekuate çështjen e viktimës si fëmijë në situatë rruge.
59. Avokati i Popullit konsideron se QPS-ja ka dështuar në ofrimin e shërbimeve psikologjike për fëmijën që ishte keqtrajtuar seksualisht. Në mungesë të psikologut, QPS-ja ka kontraktuar një psikologe, e cila ka mbajtur vetëm një seancë psikologjike prej 25 minutash dhe me konstatime sipërfaqësore.
60. Avokati i Popullit vëren se prej momentit kur QPS-ja ishte vënë në dijeni se viktima ishte abuzuar seksualisht, kishin kaluar rreth 43 ditë që viktima nuk kishte marrë shërbime të nevojshme psikologjike.
61. Avokati i Popullit vëren se autoritetet kompetente shtetërore nuk kishin treguar aftësi të nevojshme për menaxhimin e rasteve të tilla. Ato duhet ta rrisin edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional, me të vetmin qëllim: parandalimin e situatave të ngjashme dhe ofrimin e shërbimeve adekuate për viktimat.
62. Pas analizimit të dokumentacionit të çështjes në PK, Avokati i Popullit vëren se kundër të dyshuarit ishin referuar një numër i madh i rasteve në Prokurorinë e Shtetit për dyshimin e kryerjes së veprave të caktuara penale dhe kundër të njëjtit ishin ngritur 15 aktakuza.
63. Avokati i Popullit konstaton se, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dëmtuarit ose të viktimës, aq më shumë kur i dëmtuari është fëmijë – viktimë e dhunës seksuale, PK-ja kishte dështuar t'i informonte mbrojtësit të viktimave dhe se me vonesë e kishte intervistuar viktimën dhe e kishte njoftuar për të drejtat si palë e dëmtuar (neni 77 dhe 62 i KPP-së).

64. Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit të çështjes, konstaton se organi i kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen, si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të të rriturve.
65. Avokati i Popullit konsideron se institucionet për mbrojtjen e fëmijës janë të obliguara të zhvillojnë dhe të zbatojnë programe sociale që ofrojnë mbështetje për fëmijën dhe për familjen, me qëllim që të parandalohet rreziku për jetën, për dhunën, për neglizhencën, për abuzimin dhe për shfrytëzimin.
66. Në këto rrethana, Prokuroria e Shtetit dhe PK-ja do duhej të bënin më shumë për ndërmarrjen e veprimeve efektive të parashikuara me KPP dhe me ligjet relevante, në kuadër të fushëveprimit të tyre dhe se mosveprimi i tyre paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe nga neni 2 i KEDNj-së.
67. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“(…) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (…)*”, si dhe: *“të rekomandojë […] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Prokurorisë Themelore në Prishtinë

1. Inicimin e hetimeve të brendshme lidhur me dështimin e Prokurorisë për përmbushjen e detyrimeve pozitive për mbrojtjen e së drejtës për jetë.
2. Në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale, rastet e tilla të trajtohen në mënyrë efektive dhe me urgjencë, duke vlerësuar e siguruar edhe masa adekuate ligjore për kryerësin e dhunës seksuale.

Policisë së Kosovës

3. Ngritjen e kapaciteteve profesionale të Policisë së Kosovës lidhur me të drejtën në jetë dhe aspektet procedurale për hetime efektive në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale.
4. Në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale, të njoftohet menjëherë Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave.
5. Për zyrtarët policorë që punojnë me fëmijë të ofrojë trajnime për qasje të bazuar në të drejtat e fëmijëve dhe në qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve.


Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

6. Në bashkëpunim me Komunën e Fushë Kosovës, t’i forcojnë dhe t’i zhvillojnë kapacitetet e QPS-së për ofrimin e shërbimeve cilësore profesionale për fëmijët

viktima të dhunës seksuale dhe për fëmijët dhe familjet e tyre që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë, me qëllim që të parandalohet rreziku për jetën, për dhunën, për neglizhencën, për abuzimin dhe për shfrytëzimin.

7. Në bashkëpunim me Komunën e Fushë Kosovës, t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e psikologëve në QPS.
8. Për punonjësit e QPS-së që punojnë me fëmijë të ofrojë trajnime për qasje të bazuar në të drejtat e fëmijëve dhe për qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit